



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:224241

Datë: 14.11.2024

Numri i dokumentit: 06456396

P.nr.498/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarve A. H. nga J., Ç. B. nga J., S. C. nga J. dhe P. G. nga J., të cilin e mbron Valmir Marevci av. nga Lipjani, e të cilit i akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.6362/23 të dt.23.10.2023, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Vjedhja nga neni 313 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe B. P. nga J., për shkak të veprës penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjete veprës penale nga neni 333 par.2 të KPRK-së, në shqyrtimin gjyqësor, publik, të mbajtur me datën 17.10.2024, në prani të prokurorit të shtetit Paulin Pashku, të akuzuarve, mbrojtësit të të akuzuarit të katërt Valmir Marevci av. nga Lipjani, dhe të dëmtuarit K. G. nga J., e në mungesë të dëmtuarve të tjerë, në po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarve:

1.A. H., i lindur më datë ... në P., me vendbanim në rr. „Sh. Gj.” J.-L., nga babai Hajdin e ëma Xh., mbiemri i vajzerisë Xh., i pamartuar, shkollimi fillor, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në paraburgim nga dt.21.10.2023 deri me dt.21.11.2023, mbrohet në liri.

2.Ç. B., i lindur më datë ... në P., me vendbanim në J. –L., nga babai N. e ëma M., mbiemri i vajzërisë Xh., shkollimi i mesëm, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në paraburgim nga dt.21.10.2023 deri me dt.21.11.2023, mbrohet në liri.

3.S. C., i lindur më datë ... në J.-L., me vendbanim në J.–L., nga babai I. e ëma S., mbiemri i vajzërisë K., i martuar, shkollimi i mesëm, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në paraburgim nga dt.21.10.2023 deri me dt.21.11.2023, mbrohet në liri.

4.P. G., i lindur më datë ... në J.-L., me vendbanim në J.–L., nga babai A. e ëma F., mbiemri i vajzërisë M. i martuar, shkollimi i mesëm, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në paraburgim nga dt.21.10.2023 deri me dt.21.11.2023, mbrohet në liri.

5.B. P., i lindur me dt...., në P. me vendbanim në J., nga i ati B. dhe e ëma V., e gjinisë I., i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

JANË FAJTOR

Sepse:

I. Të akuzuarit A. H., S. C., C. B. dhe P. G.

Ekziston dyshim i bazuar se gjatë muajit Gusht-Tetor 2023 në intervale të ndryshme kohore në J.–L. në shtëpitë e të dëmtuarve K. G., F. G. dhe M. B., të pandehurit në bashkëkryerje dhe pas një marrëveshje paraprake në mes vete e me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të pasurisë së huaj, ashtu që me datën 30.08.2023 të dëmtuarit F. G. i kanë marr dy bateri (akumulator) të traktorëve dhe rreth 55 litra naftë në vlerë prej 200 euro, me datën 14.10.2023 të dëmtuari K. G. kanë marr 2 motor sharra dhe 2 bateri traktori në vlerë prej 1500 euro, ndërsa me datën 21.10.2023 kanë hyrë në oborrë të dëmtuarit M. B. dhe nga aty kanë marr nga dy traktoret rreth 60 litra naftë dhe janë larguar nga vendi i ngjarjes, me çka të dëmtuarve ju kanë shkaktuar dëm pasuror,-

-me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vjedhje nga neni 313 par.1 lidhur me neni 31 të KPRK-së,

II. I akuzuari B. P.

Gjatë muajit tetor të viti 2023 në shtëpinë e tij në fsh. J. K.L. i pandehuri B. P. ka blerë një motorsharrë të llojit “Still” në kundërvlerë prej 45 euro nga i pandehuri A. H. edhe pse ka mundur të dijë se sendi i blerë është i përfituar me veprë penale,

Me këtë ka kryer veprën penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 par 2 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartëcekura si dhe dispozitave të neneve 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21, 31, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 50, 52, 69 dhe neni 313 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, neni 333 par 2 të KPRK-së, si dhe neni 364 të KPPK-së, të akuzuarve i shqipton:

DËNIM ME KUSHT DHE ME GJOBË

Të akuzuarin e parë **A. H.** dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1 vitit nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet ku do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga dt.21.10.2023 deri me dt.21.11.2023 dhe

Me dënim me gjobë në shumë prej prej 500.00-€ (pesëqindeuro), të cilin dënim i akuzuari detyrohet ta paguaj në afat prej 15 dite, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë, konform neni 43 par.3 të KPRK-së do të zëvendësohet me dënim me burgim, për një ditë burgu do ti llogaritet shuma prej 20.-€.

Të akuzuarin e dytë **Ç. B.** dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1 viti nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet ku do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga dt.21.10.2023 deri me dt.21.11.2023 dhe

Me dënim me gjobë në shumë prej prej 500.00-€ (pesëqindeuro), të cilin dënim i akuzuari detyrohet ta paguaj në afat prej 15 dite, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë, konform neni 43 par.3 të KPRK-së do të zëvendësohet me dënim me burgim, për një ditë burgu do ti llogaritet shuma prej 20.-€.

Të akuzuarin e tretë **S. C.** dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1 viti nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet ku do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga dt.21.10.2023 deri me dt.21.11.2023 dhe

Me dënim me gjobë në shumë prej prej 500.00-€ (pesëqindeuro), të cilin dënim i akuzuari detyrohet ta paguaj në afat prej 15 dite, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, në të

kundërtën dënimi me gjobë, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së do të zëvendësohet me dënim me burgim, për një ditë burgu do ti llogaritet shuma prej 20.-€.

Të akuzuarin e katërt **P. G.** dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1 viti nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet ku do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga dt.21.10.2023 deri me dt.21.11.2023 dhe

Me dënim me gjobë në shumë prej prej 500.00-€ (pesëqindeuro), të cilin dënim i akuzuari detyrohet ta paguaj në afat prej 15 dite, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së do të zëvendësohet me dënim me burgim, për një ditë burgu do ti llogaritet shuma prej 20.-€.

Të akuzuarin e pestë **B. P.** dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1 viti nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

DETYROHEN të akuzuarit A. H., S. C., Ç. B. dhe P. G., që solidarisht të dëmtuarit K. G. nga J., t'ia kompenzojnë dëmin e shkaktuar në shumë prej 1,000.00-€, të dëmtuarit F. G. tia kompenzojnë dëmin në vlerë prej 200 euro dhe të dëmtuarit M. B. tia kompenzojnë dëmin në vlerë prej 100 euro, në afat prej 30 dite nga dita e dorëzimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm,

DETYROHEN të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të procedurës penale kësaj gjykate secili veç e veç t'ia paguajnë në emër të paushallit gjyqësor shumën nga 30-€, si dhe shumën nga 20-€, në Fondin e Kompensimit të Viktimave të Krimin, të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.6362/23 të dt.23.10.2023, i ka akuzuar të akuzuarit A. H. nga J., Ç. B. nga J., S. C. nga J. dhe P. G. nga J., për shkak të veprës penale bashkëkryerje Vjedhja nga neni 313 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe B. P. nga J., për shkak të veprës penale Blerja, pranimit ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 par.2 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarëve pasi që pranimit i fajsisë është bërë në mënyrë të sinqert nga ana e të akuzuarëve, duke i propozuar gjykatës që të pranohet pranimit i fajsisë. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërsi pranë aktakuzës ndaj të akuzuarëve, provat e ngritura dhe nga vetë deklarimi i tyre është vërtetuar gjendja faktike si në aktakuz, duke i propozuar gjykatës që me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit të miren parasysh mënyra dhe rrethanat e kryerjes, pasojat tek i dëmtuari dhe e kaluara kriminale e tyre dhe tju shqiptohet një dënim në bazë të ligjit.

I dëmtuari në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarëve dhe ka paraqitur kërkesën pasuroro juridike në shumë prej 1500 euro, një motorr i është kthyer dhe borxhi është tani 1000 euro. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit kërkoj kompenzimin e dëmit, nuk është që të dënohen të njëjtit por kërkoj dëm shpërblim.

I akuzuari i parë A. H. në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se e pranon fajësinë siç e ka pranuar edhe në sencën fillestare, por më është refuzuar nga ana e gjykatës pranimit i fajsisë, andaj e ka lutur gjykatën që të aprovohet pranimit i fajsisë nga se ndihet fajtor dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmën nuk do të përsëritet ky veprim. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsëritet sjellje të tilla e ka lutur gjykatën që ti shqipton një dënim sa më të butë dhe është penduar për këtë vepër dhe tash është duke punuar dhe do të kujdeset për familje.

I akuzuari i dytë Ç. B. në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se e ndij vetin fajtor për veprën penale e cila i vëhet në barrë dhe njëherit ka shtuar se këtë e ka bërë edhe në seancën fillestare dhe i ka propozuar gjykatës të aprovohet pranimi i fajsisë. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se që të ketë parasysh rrethanat lehtësuese, gjendjen jo të mirë ekonomike dhe ti shqipton një dënim sa më të butë.

I akuzuari i tretë S. C. në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe ka kërkuar falje për gabimin që e ka bërë dhe nuk do të përsëritet në të ardhmën dhe roli im në kryerjen e kësaj vepre ka qenë vetëm pjesmarrja e ime në dërgimin e të akuzuarit në shtëpi. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se ndihet i penduar dhe i gjendjes jo të mirë ekonomike dhe ka kërkuar nga gjykata që ti shqipton një dënim sa më të butë nga se roli i tij ka qenë shumë i vogël në kryerjen e kësaj vepre penale.

I akuzuari i katërt P. G. në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se e ndin vetin fajtor për veprën penale e cila i vëhet në barrë, ndihem i penduar dhe i ka premtuar gjykatës se kjo nuk do të përsëritet në të ardhmën dhe ka shtuar se veprimi im në krahasim me tjerët ka qenë vetëm sigurimi i veturës, e ka lutur gjykatën që ti shqipton një dënim sa më të butë. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se

Mbrojtësi i të akuzuarit të katërt në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajsisë nga klienti i tij dhe i ka propozuar gjykatës që ta aprovon pranimin e fajsisë. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbete në tërsi si në deklarimet paraprake, ka kërkuar nga gjykata që klienti i tij P. G. të dënohet sa më butë nga se është mbajtës i familjes 3 anëtarsh, është i gjendjes jo të mirë ekonomike, është penduar, ka premtuar se nuk do të përsërit sjellje të tilla dhe e ka lutur gjykatën që të njejtiti ti shqiptoj një dënim sa më të butë. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërsi si në deklarimet paraprake dhe ka kërkuar nga gjykata që klienti i tij të dënohet sa më butë ngase është mbajtës i familjes 3 antarshe, i gjendjes jo të mirë ekonomike, është penduar dhe ka premtuar se nuk do të përsëritë sjellje të tilla dhe e ka lutur gjykatën që të njejtiti ti shqipton një dënim sa më të butë.

I akuzuari i pestë B. P. në shqyrtimin fillestar të dt.07.12.2023 ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe ndihet i penduar por motorrsharrën A. e ka sjellë në shtëpi, ka gabuar dhe ka kërkuar falje dhe është i moshës së re dhe poashtu i gjendje së varfër ekonomike dhe e ka lutur gjykatën që ti shqipton një dënim sa më të butë.

Vlerësimi i gjykatës lidhur me pranimin e fajësisë

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, dhe po ashtu pas konsultimit të mjaftushm këtu i akuzuari i katërt me mbrojtësinë tij, pranimi i fajit nuk është rrezultat i forcës, kërcënimeve apo premtimeve të kundërligjshme, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk është e përfshirë në shkelje të qarta ligjore e as gabime faktike, konformë nenit 242 të KPPK-së, e pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve për veprat penale për të cilat akuzohen.

Matja dhe caktimi i dënimit

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuari e parë A. H., gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat personale dhe familjare pra, faktin se i njëjti është i moshës së re që lenë për të kuptuar se në të ardhmen mund të bëhet anëtar i dobishëm i shoqërisë, sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla, e veqanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të akuzuarin pra faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese dhe duke marr për bazë shkallën e rrethikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtiti i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 38 dhe 47 të KPRK-së.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin e dytë Ç. B., gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat personale dhe familjare pra, faktin se i njëjti është i moshës së re që lenë për të kuptuar se në të ardhmen mund të bëhet anëtar i dobishem i shoqërisë, sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale, dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla, e veqanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të akuzuarin pra faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 38 dhe 47 të KPRK-së.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin e tretë S. C., gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat personale dhe familjare pra, faktin se i njëjti është i moshës së re që lenë për të kuptuar se në të ardhmen mund të bëhet anëtar i dobishem i shoqërisë, sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale, dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla, e veqanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të akuzuarin pra faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 38 dhe 47 të KPRK-së.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin e katërt P. G., gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat personale dhe familjare pra, faktin se i njëjti është i moshës së re që lenë për të kuptuar se në të ardhmen mund të bëhet anëtar i dobishem i shoqërisë, sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale, dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla, e veqanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të akuzuarin pra faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 38 dhe 47 të KPRK-së.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin e pastë B. P., gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat para kryerjes së veprës penale, pra faktin se i njëjti për herë të parë ka rënd ndesh me ligjin, rrethanat personale dhe familjare pra, faktin se i njëjti është i moshës së re që lenë për të kuptuar se në të ardhmen mund të bëhet anëtar i dobishem i shoqërisë, sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale, dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla, e veqanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të akuzuarin pra faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 47 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës

Vendimi për shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 449 dhe 450 të KPPK-së, ku shuma prej 30-€ në emër të paushallit gjyqësor u caktua në bazë të ndërlëshmërisë së rastit, ndërsa shuma prej 20-€ për Kompenzimin e Viktimave të Krimit u bazua në nenin 36 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të Krimit.

Kërkesa pasurore-juridike

Gjykata konform nenit 56 par.1 nënpar.1.12 të KPRK-së, i shqiptoj urdhërin për kompensimit e të dëmtuarit në shumën prej 1000 euro dhe i detyroj të akuzuarit që t'ia kompensojnë solidarisht në afat prej 30 dite demin te dëmtuarve,

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN

P.nr.498/23 dt.17.10.2024

GJYQTARI
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 30 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.